Save the Children

OMBUDSPERSON

# ZËRI YNË

# ZËRI YNË 2016


***Nga Save the Children në Kosovë:***
Linda Hoxha
Aida Emini
Rudina Ademi Shala
Rebeka Qena

***Nga Institucioni i Avokatit të Popullit:***
Igballe Rrahmani
Lulkuqe Gashi

***Nga Save the Children Suedi:***
Barbara Voors
Karin Fyrk



***Editimi dhe Lektorimi:***
Commit

# Lista e Figurave

Figura 1 Përgjigjet në pyetjen "A jeni …vajzë apo djalë?" Përqindja është bazuar në gjini.....11

Figura 2 Përgjigjet në pyetjen "Në cilën klasë jeni?" Shpërndarja e pjesëmarrësve është bazuar në klasë.....11

Figura 3 Përgjigjet në pyetjen "A keni pasur mundësi t'i shprehni mendimet tuaja apo të ndikoni për ndonjë çështje të rëndësishme, në këtë gjysmëvjetor apo në gjysmëvjetorin e kaluar? .....12

Figura 4 Përgjigjet në pyetjen "A keni pasur mundësi të jepni mendimet tuaja apo të ndikoni për ndonjë çështje të rëndësishme për ju?".....12

Figura 7. Përgjigjet lidhur me nivelin e sigurisë në vendet e sipërpërmendura, të ndara sipas gjinisë.....15

Figura 8 Përgjigjet në pyetjen "A jeni ndjerë të trishtuar dhe të pa disponuar për një periudhë më të gjatë kohore gjatë këtij gjysmëvjetori apo gjatë gjysmëvjetorit të kaluar?".....16

Figura 9 Përgjigjet në pyetjen: "A ju ka ndodhur kjo në këtë gjysmëvjetor apo në gjysmëvjetorin e kaluar?" E ndarë sipas gjinisë .....17

Figura 10. Përgjigjet në pyetjen "A keni ndjerë ndonjërin prej shqetësimeve në vijim gjatë këtij gjysmëvjetori apo gjatë gjysmëvjetorit të kaluar?".....17

Figura 11 Të dhënat e ndara sipas klasave .....17

Figura 12 Përgjigjet në pyetjen "A e dini se ku duhet të shkoni nëse keni nevojë të bisedoni me dikë ose të kërkoni ndihmë?" .....18

Figura 13 Përgjigjet në pyetjen "A ju ka kërkuar mësuesi (apo ndokush tjetër në shkollë) që të sillni para për të paguar ushqimin në piknik, në ekskursion ose në ndonjë aktivitet të lirë, këtë gjysmëvjetor ose në gjysmëvjetorin e kaluar?".....19

Figura 14 Përgjigjet në pyetjen "A mendoni se fëmijët dhe stafi tjetër i shkollës suaj punojnë në drejtim të ndalimit të talljes (bullying)?" .....20

Figura 15 Përgjigjet në pyetjen "A jeni brengosur për një prej çështjeve në vijim gjatë këtij gjysmëvjetori apo gjatë gjysmëvjetorit të kaluar?".....21

Figura 16 Përgjigjet në pyetjen "A jeni ndjerë ndonjëherë të stresuar për detyrat e shkollës gjatë këtij gjysmëvjetori apo gjatë gjysmëvjetorit të kaluar?".....22

Figura 18 Përgjigjet në pyetjen "A ju ndihmojnë në shtëpi lidhur me detyrat e shtëpisë?" .....23

Figura 19. Përgjigjet në pyetjen "A ju ofron shkolla juaj mundësi për të paraqitur mendimet tuaja, për shembull për ushqimet në shkollë, pushimet, detyrat e shkoillës ose gjërat e tjera që kanë të bëjnë me shkollën ?".....24

Figura 20. Përgjigjet në pyetjen"A u janë prezantuar të drejtat në shkollën tuaj këtë gjysmëvjetor apo në gjysmëvjetorin e kaluar?" "A keni dëgjuar për të drejtat e fëmijëve?" "A u është prezantuar Konventa për të Drejtat e Fëmijës në shkollën tuaj këtë gjysmëvjetor apo në gjysmëvjetorin e kaluar?" dhe "A keni dëgjuar për Konventën për të Drejtat e Fëmijës?" .....25

Figura 21 Përgjigjet në pyetjen "A keni dëgjuar për Konventën për të Drejtat e Fëmijës?" të ndara sipas komunës.....26

# Tabela e Përmbajtjes


Parathënie ..... 7
Rezultatet kryesore të "*Zëri Ynë*" 2016 ..... 8
Çfarë është "*Zëri Ynë*"? ..... 9
Çfarë dëshiron Save the Children? ..... 10
Si e ka bërë këtë Save the Children? ..... 10
Pjesëmarrësit ..... 11
Respektimi i pikëpamjeve të fëmijëve ..... 12
E drejta për t'u ndjerë mirë dhe sigurt ..... 13
Tallje (bullying) dhe ngacmim ..... 13
Dhuna ..... 16
Shtëpia dhe familja ..... 16
Të ndjerit keq ..... 16
Çrregullimet në të ngrënë, të ndara sipas gjinisë ..... 17
Të shqetësuar për vetë-lëndim ..... 17
Ndihma dhe mbështetja ..... 18
Rritja në rrethana të ndryshme ..... 18
Gjendja më e dobët financiare ..... 19
Dallimet në mes vendeve ku jetojnë fëmijët ..... 20
A e ndalon shkolla talljen (bullying)? ..... 20
Dallimet në mes djemve dhe vajzave ..... 21
Shkolla dhe arsimimi për të gjithë ..... 22
Stresi për detyrat e shkollës ..... 22
Stresi për nota ..... 23
Ndihma në shtëpi për kryerjen e detyrave të shtëpisë ..... 23
Mjedisi i punës dhe ndikimi në shkollë ..... 24
Ndikimi në shkollë ..... 24
"Nxënësit duhet të kenë zë të barabartë në proceset e vendimmarrjes" ..... 24
Njohuria për të drejtat ..... 24
Vetëdijesimi për të drejtat e fëmijëve ..... 25
Njohuria për Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës: sipas komunës ..... 26
Fëmijët që nuk dinë se ku të drejtohen… ..... 26
Prania e Avokatit të Popullit në të gjitha komunat ..... 26
E ardhmja ..... 26
Si e mendojnë fëmijët të ardhmen e tyre? ..... 27
Shtojca 1 ..... 28

Si pjesë e sistemit të llogaridhënies në *Save the Children*:
Nëse keni ndonjë ankesë, feedback ose pyetje, ju lutem na shkruani në: *scik@savethechildren.org*

# Parathënie

**“Të gjeturat e këtij hulumtimi duhet të përdoren dhe të shërbejnë si udhëzues për përmirësimin e situatës së fëmijëve në Kosovë.”**

Save the Children në Kosovë, në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë, e ka realizuar hulumtimin “*Zëri Ynë*”, për të adresuar pikëpamjet e fëmijëve lidhur me të gjitha çështjet që i prekin ata, për të cilat ata kanë të drejtë sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

“*Zëri Ynë*” është inspiruar nga Save the Children në Suedi, e realizuar në vitin 2014.[1]

“*Zëri Ynë*” është një hulumtim me 1588 të rinj të moshës 12-16 vjeç e realizuar nga Save the Children në mbarë Kosovën, në mënyrë që të merren pikëpamjet dhe idetë e tyre mbi dhunën, talljen (bullying), shpenzimet në shkollë, njohurinë për të drejtat, për të ardhmen dhe shumë të tjera. Është e drejtë e fëmijëve që të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre lidhur me realizimin e të drejtave të tyre. Ndjenjat e fëmijëve duhet të njihen dhe të merren parasysh në të gjitha mjediset që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre. Këtu përfshihen shkolla, shtëpia, aktivitetet në kohën e lirë dhe komuniteti, si dhe vendimarrja politike për çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët. Për më tepër, vendimmarrësit duhet t’i njohin përvojat dhe pikëpamjet e fëmijëve në mënyrë që ta kuptojnë më mirë situatën e përgjithshme të fëmijëve. Ndikimi i fëmijëve në vendimmarrje, në mënyrë specifike në vendimet që i prekin ata në mënyrë të drejtpërdrejtë, do t’i pasurojë dhe do t’i përmirësojë vendimet si dhe do të nxisë zbatimin e tyre.

Objektivi i hulumtimit “*Zëri Ynë*” është që ajo të bëhet një mjet i dobishëm për diskutimet me politikanë, me politikëbërës dhe me palë të tjera të interesit lidhur me kushtet e fëmijëve dhe të të rinjve. Shpresojmë se “*Zëri Ynë*” do të nxisë krijimin e sferave të ndikimit në të gjitha nivelet, gjithnjë në bazë të kushteve të vetë fëmijëve.

Në Kosovë, Qeveria dhe Parlamenti, si dhe komunat, mbajnë përgjegjësi për çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët dhe të rinjtë. Duke marrë parasysh që Kosova e ka përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) në Kushtetutën e saj, të gjithë akterët e përmendur më sipër janë përgjegjës për të bërë ndryshime në jetën e fëmijëve.

Situata e fëmijëve në Kosovë është përmirësuar shumë, mirëpo hulumtimi “*Zëri Ynë*” tregon se duhet të bëhet edhe shumë punë në këtë drejtim.

1 *Zëri Ynë* (2014). Save the Children në Suedi.

# Rezultatet kryesore të "*Zëri Ynë*" 2016

- 63.4% e fëmijëve tregojnë se janë të trishtuar dhe të pa disponuar për një kohë të gjatë; 54.1% tregojnë se ndjehen të trishtuar dhe të pa disponuar shumë shpesh; 36.6% tregojnë se ndonjëherë ndjehen të trishtuar dhe të pa disponuar.
- 35.7% e vajzave dhe 36.4% e djemve shqetësohen nga tallja (bullying) .
- 32.9% e fëmijëve janë ndjerë të tallur (bullied) ose të ngacmuar gjatë këtij gjysmëvjetori apo gjysmëvjetorit të fundit.
- Tre prej pesë fëmijëve stresohen për shkak të detyrave shkollore; 53% janë të stresuar nganjëherë; 16.1% kanë shumë stres.
- 63% e vajzave dhe 54.3% e djemve shqetësohen se nuk mund t'ia dalin mirë në shkollë.
- Pothuaj katër prej pesë fëmijëve janë të stresuar për shkak të notave. 50% kanë raportuar se nganjëherë kanë pasur stres për shkak të notave, 28.3% kanë raportuar se kanë shumë stres për shkak të notave, ndërsa 21.7% kanë treguar se fare nuk kanë stres për notat.
- 96% e fëmijëve ndjehen të sigurt në shtëpi, ndërsa 81.1% gjithmonë ndjehen të sigurt në klasë.
- 75.6% e kanë parë dikë të jetë goditur ose qëlluar, vitin e kaluar.
- Rreth 96% e fëmijëve kanë dëgjuar për të drejtat e fëmijëve dhe KDF-në,
- megjithatë...
  - 50.3% e fëmijëve tregojnë se nuk dinë se ku duhet të drejtohen kur kanë probleme në familje.
  - 41.7% e fëmijëve nuk dinë se ku duhet të drejtohen kur keqtrajtohen.
- 84% e fëmijëve thonë që Kosova duhet të bëjë më shumë për ta siguruar praninë e Institucionit të Avokatit të Popullit në secilën komunë.
- 84% e të gjithë të rinjve në Kosovë e shohin të ardhmen e tyre në mënyrë pozitive.
- 24.6% e fëmijëve që jetojnë në fshatra raportojnë se janë ballafaquar me së paku një prej pengesave financiare në vijim: 1) me pamundësinë për të marrë pjesë në aktivitete shkollore; 2) me pamundësinë për të paguar uniformën e shkollës apo mjetet e tjera mësimore; 3) me pamundësinë për të marrë pjesë në kurse jashtë planprogramit shkollor.

# Çfarë është "*Zëri Ynë*"?

"*Zëri Ynë*" është një hulumtim që tregon se çfarë mendojnë fëmijët lidhur me çështje të ndryshme. Ajo është realizuar në mbarë vendin, nëpërmjet pyetësorëve. Pyetjet i adresojnë përgjegjësitë dhe temat, si në nivelin komunal ashtu edhe në atë nacional, si: pjesëmarrja në vendimmarrje, arsimi, siguria, e ardhmja dhe çështjet psikologjike. Rezultatet kuantitative të këtij hulumtimi janë analizuar dhe janë diskutuar me fëmijët, duke përdorur metodologjinë e diskutimit në fokus-grupe. Pjesëmarrësit në fokus-grup kanë qenë fëmijë nga Prishtina, Mitrovica, Gjakova, Peja, Gjilani, Ferizaj, Klina, Fushë Kosova dhe Skënderaj.

Të gjitha citatet e përdorura në këtë raport janë marrë nga diskutimet me fëmijë në fokus-grupe. Hulumtimi ka përmbajtur nene të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF), duke mbuluar edhe fusha të tjera, në të cilat punon Save the Children.

Ky hulumtim fillimisht është realizuar në Suedi dhe Save the Children në Kosovë e ka përshtatur atë, në mënyrë që t'i përshtatet më mirë konteksit të Kosovës. Hulumtimi "*Zëri Ynë*" është realizuar në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.

Duke ditur që Kosova nuk pranon rekomandime nga Komisioni për të Drejtat e Fëmijës, për të përcjellë se sa është në përputhje Kosova me këtë Konventë, ne e kemi përshtatur këtë raport me temat që janë të rëndësishme për hulumtim lidhur me mënyrën se si e përceptojnë fëmijët situatën.

## Çfarë dëshiron Save the Children?

**"Ne mund të jemi të kënaqur atëherë kur të gjithë marrim pjesë në proceset e vendimmarrjes – çdo nivel tjetër nuk do të na kënaqte."**

"*Zëri Ynë*" është një pasqyrë e perceptimit të situatës nga fëmijët dhe se si e vlerësojnë ata nivelin e respektimit dhe realizimit të drejtave të tyre. Hulumtimi ka për qëllim shpërndarjen e informacioneve, në mënyrë që të rriturit që kanë ndikim në jetën e fëmijëve t'u kushtojnë vëmendje perceptimit të fëmijëve dhe të punojnë në atë drejtim. Save the Children, në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit, dëshiron që Kuvendi, Qeveria, komunat dhe shkollat të krijojnë struktura dhe të ndërmarrin procedura për të marrë mendimin e fëmijëve dhe për të siguruar që ato mendime merren parasysh në të gjitha vendimet lidhur me fëmijët. Puna e mëtutjeshme duhet të përshtasë një qasje e cila gjithmonë bazohet në interesin më të mirë të fëmijës.

Save the Children në Kosovë shpreson se rezultatet nga "*Zëri Ynë*" vërtet do të ndryshojnë ose do të jenë pjesë e politikave të reja dhe do t'i rrisin shpenzimet në fusha të caktuara të interesit, e gjithë kjo për të përmirësuar jetën e fëmijëve dhe të rinjve.

**"Nuk duhet të bëhet presion për të ndryshuar një vendim që është i dëmshëm – ne duhet të pyetemi dhe të konsultohemi, para se të merret çdo vendim."**

## Si e ka bërë këtë Save the Children?

Procesi i mbledhjes së të dhënave për hulumtimin "*Zëri Ynë*" është bërë në periudhën tetor 2015 – janar 2016. Metodologjia është dizajnuar nga stafi i Save the Children në Kosovë, në bazë të modelit të Save the Children në Suedi.

Pyetjet e hulumtimit janë rishikuar nga fëmijët e moshës 14 – 18 vjeç, në bashkëpunim me stafin e Save the Children në Kosovë dhe me përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit. Për mbledhjen e të dhënave janë punësuar dhe trajnuar si hulumtues në terren 10 studentë të universitetit.

Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave, para plotësimit të pyetësorit, nxënësve u është dhënë një listë e përkufizimeve për termet që konsideroheshin të vështira për t'u kuptuar për ta. Në mënyrë specifike, përkufizimet për "diskriminim etnik", "siguri në internet", "talljen (bullying)" dhe "talljen (bullying) në internet".

Për t'i parë pyetjet dhe të gjitha rezultatet e këtij hulumtimi , ju lutem shihni Shtojcën 1 ose vizitoni: https://kosovo.savethechildren.net/

Në këtë hulumtim është aplikuar metodologjia e mostrimit të rastit, në shumë faza. Pas analizës së mostrës janë mbuluar të shtatë rajonet e Kosovës. Hulumtimi "*Zëri Ynë*" është realizuar në 20 komuna, në gjithsej 34 vendbanime. Hulumtimi nuk është realizuar në katër komunat në veri: Mitrovicë, Zubin Potok, Leposaviq e Zveçan, si edhe në komunën e Ferizajit.

Përveç përzgjedhjes së shkollave, marrja e rastësishme e mostrave është përdorur edhe për përzgjedhjen e klasave dhe nxënësve. Grupacion i synuar ishin fëmijët e shkollës fillore të klasës VI – IX. Anketuesit janë trajnuar që t'i sugjerojnë nxënësit se askush nuk do të ketë mundësi t'i shohë përgjigjet e tyre dhe t'u garantohet edhe anonimiteti maksimal i tyre.

Baza e të dhënave në ueb është dizajnuar nga eksperti i statistikës, për të zvogëluar gabimet e mundshme. Kjo bazë e të dhënave është filtruar për t'u shërbyer nevojave të pyetësorit "*Zëri Ynë*". Të dhënat e futura në bazën e të dhënave në ueb janë importuar direkt nga tabelat në Excel, ku është bërë edhe analiza përshkruese e tyre. Për të kontrolluar gabimet, secili pyetësor është emërtuar me një numër identifikues.

## Pjesëmarrësit

Më se 1588 fëmijë të Kosovës janë pyetur për të drejtat e tyre, përmes hulumtimit "*Zëri Ynë*".

Diagramet e mëposhtme ilustrojnë përqindjen e vajzave dhe të djemve që kanë marrë pjesë, si edhe përkatësinë e pjesëmarrësve sipas klasave.




Figura 1. Përgjigjet në pyetjen "A jeni …vajzë apo djalë?" Përqindja është bazuar në gjini

Përfaqësimi gjinor ka qenë 50.8% për vajza dhe 49.2% për djem. Kjo ndarje paraqet edhe një përfaqësim të qartë të popullsisë së përgjithshme.




Figura 2. Përgjigjet në pyetjen "Në cilën klasë jeni?" Shpërndarja e pjesëmarrësve është bazuar në klasë

Për hulumtimin "*Zëri Ynë*" kanë kontribuar fëmijët e 30 fshatrave dhe 19 komunave.

Pyetësori i ka pasur gjithsej 30 pyetje, shumica e të cilave kanë qenë pyetje me përgjigje të shumëfishta.

Pyetësori ka filluar me pyetjet për çështje demografike, e pastaj ka vijuar me 30 pyetje standarde të hulumtimit "*Zëri Ynë*".

Pyetjet janë grupuar në katër faktorë:

- Siguria
- Pengesat për shkak të kostos
- Faktorët psiko-socialë
- Pjesëmarrja dhe ndikimi

Është bërë edhe analiza përshkruese, me krahasime sipas gjinisë, komunës dhe vendbanimit (që nënkupton njësinë më të vogël se komuna). Këto rezultate do të sqarohen dhe do të diskutohen në kapitujt vijues.

# Respektimi i pikëpamjeve të fëmijëve

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë t'i shprehin lirshëm pikëpamjet e tyre lidhur me të gjitha çështjet që i prekin ata. Fëmijët, zakonisht, nuk kanë mundësi që në mënyrë zyrtare të ngrisin zërin e tyre. Është përgjegjësi dhe obligim i të rrituve që t'i dëgjojnë, t'i respektojnë dhe t'i marrin parasysh mendimet e fëmijëve lidhur me vendimet që merren për ta. Fëmijët kanë të drejtë t'i shprehin mendimet e tyre dhe ato duhet të merren seriozisht. Kjo vlen për të gjitha ambientet, për shembull, në shkollë, në shtëpi ose në komunë. Shumica e fëmijëve të Kosovës nuk janë të kënaqur me nivelin e ndikimit që kanë ata sot. Një përqindje e madhe e tyre, më se 86.4%, thonë se dëshirojnë të kenë më shumë ndikim në çështjet që kanë të bëjnë me ta.

Komuna është ambienti politik më i afërt dhe po ashtu, vendi ku merren shumica e vendimeve që kanë të bëjnë më fëmijët. "*Zëri Ynë*" tregon se shumica e fëmijëve në Kosovë (72.7%) janë mjaft të sigurt dhe kanë mundësi që ata të ndikojnë në vendimet e komunës. Pas kësaj pyetje, të anketuarit janë pyetur: "A keni pasur mundësi të jepni mendimet tuaja dhe të ndikoni në ndonjë çështje që është e rëndësishme për ju, vitin e kaluar?". Më se 45.1% e fëmijëve besojnë se në të vërtetë kanë pasur mundësi të shprehin mendimet e tyre dhe të ndikojnë në çështjet që i prekin ata, gjatë vitit të kaluar. Por, prej këtyre 45.1%, vetëm 1.95% kanë pasur mundësi të ndikojnë deri diku në komunë. Kjo fushë është definitivisht në fund të listës së fushave ku fëmijët kanë pasur ndikim në çështjet që lidhen me ta. Shkolla është në fundin tjetër të kësaj liste, me 41.5%, bashkë me shtëpinë, me 32.9%.

A janë lejuar fëmijët që të ndikojnë në çështje të rëndësishme?




Figura 3 Përgjigjet në pyetjen "A keni pasur mundësi t'i shprehni mendimet tuaja apo të ndikoni për ndonjë çështje të rëndësishme, në këtë gjysmëvjetor apo në gjysmëvjetorin e kaluar?

Nëse "po" – ku kanë pasur fëmijët mundësi të ndikojnë?




Figura 4 Përgjigjet në pyetjen "A keni pasur mundësi të jepni mendimet tuaja apo të ndikoni për ndonjë çështje të rëndësishme për ju?"

**“Ata na pyesin, konsultohen me ne, mirëpo, kurrë nuk e bëjnë atë që u themi se duhet bërë.”**

Save the Children dhe të tjerët kanë bërë shumë për të punuar me mësimdhënës dhe me personelin tjetër të shkollës për të demonstruar rëndësinë e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje. Rezultatet e “*Zëri Ynë*” tregojnë se ka nevojë për punë aktive me fëmijë e me profesonistë, si dhe në fushat e tjera: në komuna, në aktivitete të kohës së lirë, shtëpi, shkollë, etj.

Vajzat dhe djemtë duket se e kanë pak a shumë të njëjtin nivel të mundësive të ndikimit, por vajzat kanë pasur pak më shumë ndikim të vërtetë vitin e kaluar. Dallimet janë shumë më të mëdha në mes të rajoneve.

**“Pjesëmarrja ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në jetën e fëmijëve dhe është një çështje që duhet të merret më seriozisht.”**

## E drejta për t’u ndjerë mirë dhe sigurt

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të kenë fëmijëri të sigurt. Ata nuk duhet të jenë viktimë e dhunës, talljes (bullying) dhe ngacmimit.

Fëmijët kanë të drejtë të ndjehen mirë dhe të ndihmohen e mbështeten, në rast se keqtrajtohen, lëndohen ose ndjehen keq. Nëse të rriturit në familje nuk kanë mundësi që fëmijëve të tyre t’u ofrojnë ndihmë ose mbështetje në situata të ndjeshme, atëherë shoqëria duhet ta marrë përgjegjësinë dhe t’u sigurojë fëmijëve ndihmën e nevojshme.

**“Mendoj se është e rrezikshme që vajzat të udhëtojnë gjatë natës ose të dalin jashtë natën. Nuk ndjehem e sigurt kur udhëtoj vetëm.”**

## Tallje (bullying) dhe ngacmim

Përmes hulumtimit “*Zëri Ynë*”, është matur edhe çështja e talljes (bullied) dhe ngacmimit në shkollë ose online. Ky raport tregon se më se 32.9% e të gjithë fëmijëve janë ndjerë të tallur (bullied) ose të ngacmuar gjatë këtij gjysmëvjetori apo gjatë gjysmëvjetorit të kaluar.

**“Ekziston një bindje në shkollë se nëse themi publikisht diçka të padrejtë, atëherë të gjithë do të qeshin me ne.”**




Figura 5 Përgjigjet në pyetjen "A jeni ndjerë të tallur (bullied) ose të ngacmuar gjatë këtij gjysmëvjetori apo gjatë gjysmëvjetorit të kaluar?"




Figura 6 Përgjigjet në pyetjen "Nëse jeni ndjerë të tallur (bullied) ose të ngacmuar gjatë vitit të kaluar, a ka qenë kjo për shkak të: (vetëm ata që janë përgjigjur "ndonjëherë" ose "shumë herë")

58.5% e të anketuarve kanë deklaruar se janë tallur (bullied) për arsye të tjera nga arsyet e përmendura më sipër, meqenëse kjo pyetje nuk ka dhënë opcione shtesë për sqarim. Ky numër është intrigues dhe hap shtigje të reja intervenimi në këtë fushë, duke nisur nga identifikimi i shkaqeve "të tjera" të talljes (bullying) e deri te të kuptuarit dhe gjetjes së mënyrave për intervenim dhe për adresim të çështjeve të identifikuara.

9.9% kanë deklaruar se janë tallur (bullied) për shkak të fesë, 8.8% për shkak të moshës dhe 22.9% kanë deklaruar se janë tallur (bullied) për shkak të pamjes fizike, gjendjes ekonomike të familjes, nevojave të veçanta, orientimit seksual ose gjinisë.

Janë ndjerë rrallë të sigurt ose nuk janë ndjerë kurrë të sigurt në vendet vijuese:

Figura 7. Përgjigjet lidhur me nivelin e sigurisë në vendet e sipërpërmendura, të ndara sipas gjinisë.

Ky diagram tregon përqindjen e fëmijëve që janë përgjigjur se rrallë janë ndjerë të sigurtë ose se nuk janë ndjerë kurrë të sigurt në vendet e listuara më sipër. Për më shumë detaje lidhur me këtë pyetje, shihni Shtojcën 1 në faqet 31 – 64, dhe vizitoni: *https://kosovo.savethechildren.net/*

Një e gjetur interesante që mund të vërehet në rezultatet e prezantuara në Figurën 7 është mospër-puthshmëria gjinore.

Në mbrëmje, vajzat ndjehen rrallë të sigurta ose nuk ndjehen kurrë të sigurta. Ky është një dallim i madh që mund të nxirret nga të dhënat e prezantuara.

## Dhuna

**“Djemtë shohin më shumë dhunë sepse ata qëndrojnë më shumë në shkollë pas përfundimit të mësimit.”**

75.6% kanë parë dikë që është goditur ose është qëlluar, vitin e kaluar. Prej numrit të përgjithshëm të fëmijëve që kanë deklaruar se e kanë parë dikë që është qëlluar ose goditur, 72.8% kanë qenë vajza, kurse 78.2% kanë qenë djem. Djemtë e klasës VI kanë qenë dëshmitarë të dhunës në një shkallë më të madhe se sa djemtë e klasës VIII dhe X. Rezultatet e ndara sipas klasave janë interesante dhe tregojnë nevojën për më shumë hulumtime në këtë drejtim. Djemtë deklarojnë se sa më të vegjël të jenë, aq më të ekspozuar ndaj dhunës janë. A është kjo për shkak të ndjeshmërisë së tyre? Përse ky numër zvogëlohet te djemtë e klasave VIII dhe X?

## Shtëpia dhe familja

Në pyetjen se ku ndjehen të sigurt, 96.3% e fëmijëve të anketuar janë përgjigjur se ata ndjehen të sigurt në shtëpitë e tyre, ndërsa 81.1% kanë thënë se ndjehen të sigurt edhe në klasë. Përgjigjet në këtë pyetje shpien në fusha të reja të hulumtimeve dhe kërkimeve potenciale. 18.9% e fëmijëve nuk ndjehen të sigurt në klasë. Kjo tregon se shkollat dhe drejtoritë komunale të arsimit duhet t’i kërkojnë arsyet e këtyre rezultateve.

## Të ndjerit keq

Hulumtimi “*Zëri Ynë*” tregon se shumë fëmijë në Kosovë nuk ndjehen mirë. Fëmijët kanë strese, shqetësime, çrregullime në të ngrënë ose vetë-lëndime. 63.4% e fëmijëve që kanë marrë pjesë në hulumtimin “*Zëri Ynë*”, janë ndjerë ndonjëherë ose shumë herë të pikëlluar dhe të dëshpëruar për një periudhë më të gjatë kohore, gjatë vitit të kaluar. Të dhënat e hulumtimit “*Zëri Ynë*” sinjalizojnë nevojën për intervenime dhe për hulumtime të mëtejshme me fëmijë, me prindër, me mësimdhënës dhe me komunitetin.

**“Në shtëpi fëmijët ndjehen pak më të sigurt se në vendet tjera.”**




Figura 8 Përgjigjet në pyetjen “A jeni ndjerë të trishtuar dhe të pa disponuar për një periudhë më të gjatë kohore gjatë këtij gjysmëvjetori apo gjatë gjysmëvjetorit të kaluar?”

## Çrregullimet në të ngrënë, të ndara sipas gjinisë




Më se 12.6% e fëmijëve kanë deklaruar se kanë pasur çrregullime në të ngrënë, gjatë jetës së tyre. Nga përgjigjet mund të shihet se vajzat kanë pasur çrregullime në të ngrënë dy herë më shumë se djemtë. Siç shihet nga Figura 9, çrregullime në të ngrënë kanë pasur 17.2% e vajzave dhe 8.3% e djemve.

Figura 10 tregon përqindjen e fëmijëve që janë shqetësuar nga vetë-lëndimet, gjatë vitit të kaluar. Më se 14.4% e djemve dhe 12.7% e vajzave kanë thënë se janë shqetë-suar për vetë-lëndim. Figura 10 paraqet të dhënat, të ndara sipas gjinisë.

Figura 9 Përgjigjet në pyetjen: "A ju ka ndodhur kjo në këtë gjysmëvjetor apo në gjysmëvjetorin e kaluar?" E ndarë sipas gjinisë

## Të shqetësuar për vetë-lëndim




Figura 10. Përgjigjet në pyetjen "A keni ndjerë ndonjërin prej shqetësimeve në vijim gjatë këtij gjysmëvjetori apo gjatë gjysmëv-jetorit të kaluar?"

Rezultatet e hulumtimit "*Zëri Ynë*" tregojnë se sa përqind të djemve dhe të vajzave kanë pasur prob-leme psikologjike dhe emocionale. Përqindja e fëmijëve që deklarojnë se ndjehen keq rritet paralelisht me moshën. Rezultatet e prezantuara në Figurën 11 tregojnë se nga klasa VI fëmijët kanë nga një mësimdhënës për secilën lëndë (më shumë se 10 mësim-dhënës) dhe kjo mund të ketë ndikim në gjendjen e tyre emocionale.

| Klasa VI | Klasa VIII | Klasa X |
|---|---|---|
| 48.6% | 37.0% | 27.7% |

Figura 11.Të dhënat e ndara sipas klasave

**"Në shkollë mësimdhënësit kanë autoritet të na lavdërojnë, mirëpo edhe të na nënçmojnë. Për shembull, i bëra mësuesit një pyetje dhe ai e përsëriti pyetjen time para gjithë klasës, duke ma përmendur emrin. Kjo më pikëlloi për një kohë shumë të gjatë."**

## Ndihma dhe mbështetja

Shumë fëmijë (50.3%) që kanë marrë pjesë në hulumtimin "*Zëri Ynë*" kanë thënë se nuk dinë se ku duhet të drejtohen kur kanë probleme në familje. 41.7% kanë deklaruar se nuk dinë ku duhet të drejtohen kur u cenohen të drejtat ose trajtohen padrejtësisht, 38.9% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk dinë ku duhet të drejtohen kur janë të përfshirë në dhunë, kërcënime ose krime të tjera 31.2% e fëmijëve kanë deklaruar se nuk dinë ku duhet të drejtohen kur kanë probleme psikologjike. Bazuar në të dhënat e prezantuara më sipër, u bëhet thirrje politikëbërësve dhe qeverisë që të kërkojnë praninë e psikologëve në shkolla, sepse kjo është qenësore për mirëqeniën mendore të fëmijëve.

**"Prindërit nuk u kushtojnë vëmendje fëmijëve të tyre, për shkak të orarit të tyre të gjatë në punë dhe kohës së kufizuar për ta kaluar me fëmijë."**

Fëmijët që nuk dinë se ku duhet të drejtohen …

Figura 12 Përgjigjet në pyetjen "A e dini se ku duhet të shkoni nëse keni nevojë të bisedoni me dikë ose të kërkoni ndihmë?"

## Rritja në rrethana të ndryshme

Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për mundësi të barabarta në jetë. Kjo nënkupton se nuk ka rëndësi se prej nga vijnë apo cilës gjini u përkasin. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të arsimohen, të kenë mbështetje dhe të jenë të mbrojtur. Kjo e drejtë është e mbrojtur me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Në Nenin 2 të Konventës thuhet:

> *" …respektim dhe sigurim i të drejtave të përcaktuara në këtë Konventë për secilin fëmijë brenda jurisdiksionit të tyre, pa kurrfarë diskriminimi, pa marrë parasysh racën, ngjyrën, seksin, gjuhën, fenë, pikëpamjet politike apo tjera, përkatësinë etnike ose sociale, pronën, aftësinë e kufizuar, lindjen ose statuset e tjera të fëmijës, prindërve të tij/saj ose të kujdestarit ligjor të tij/saj." (Konventa për të Drejtat e Fëmijës, faqe 4)*

Megjithatë, hulumtimi "*Zëri Ynë*" jep shumë shenja të dallimeve të mëdha të rrethanave në të cilat rriten fëmijët, veçanërisht fëmijët që jetojnë në familje me gjendje më të dobët financiare. Po ashtu, ka dallime varësisht prej kushteve në të cilat rriten fëmijët e Kosovës, si dhe dallimet në mirëqenien e vajzave dhe të djemve: çështjet gjinore që duhet adresuar mund të shihen qartë në këto statistika. Kushtet e ndryshme gjatë fëmijërisë shpesh nënkuptojnë se disa fëmijë nuk i kanë mundësitë e barabarta të jetesës në krahasim me fëmijët tjerë. Për ta shmangur këtë diskriminim, ne duhet të dijmë më shumë për përvojat e fëmijëve dhe të të rinjve të përfshirë në hulumtimin "*Zëri Ynë*", si dhe të bëjmë përpjekje të vazhdueshme për përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve në vendimmarrje për çështjet që kanë të bëjnë me ta.

## Gjendja më e dobët financiare

Të rinjtë shqetësohen për ekonominë e familjeve të tyre. Në pyetjen: "A jeni të shqetësuar që familja juaj nuk do të ketë mjaft para për nevojat e saj?"[2], janë përgjigjur me "po" më se 11.8% e të rinjve dhe e fëmijëve të qytetit dhe 7.5% e të rinjve dhe fëmijëve të zonave rurale. Kjo nënkupton se pothuaj 1 në 10 fëmijë shqetësohet nga pamundësia e familjes që t'i plotësojë nevojat e saj themelore.

**"Nuk mendoj se është e arsyeshme që shkolla të organizojë diçka për të cilën kërkojnë që të paguajnë fëmijët."**

Ky hulumtim tregon gjithashtu se ekziston një lidhje e qartë midis ndjeshmërisë së fëmijës ndaj gjendjes financiare të familjes dhe të të ndjerit i sigurt në shtëpi.

KDF thekson se arsimi bazë duhet të jetë "falas për të gjithë", mirëpo shumë fëmijë kanë pasur raste që kanë qenë të kufizuar të marrin pjesë në aktivitete shkollore për shkak të kostos.

14.6% e të anketuarve kanë pasur së paku një prej pengesave të përmendura më poshtë: mospjesëmarrje në aktivitete shkollore, pamundësi për ta blerë uniformën e shkollës dhe për të ndjekur kurse jashtë plan-programeve shkollore, për shkak të pengesave financiare. Kjo vlen për pothuaj çdo të shtatin fëmijë. Fëmijët e familjeve që jetojnë në kufi të varfërisë janë të privuar nga aktivitetet në shkollë, gjë që përbën diskriminimin më të madh të tyre, që në fillim.




Figura 13 Përgjigjet në pyetjen "A ju ka kërkuar mësuesi (apo ndokush tjetër në shkollë) që të sillni para për të paguar ushqimin në piknik, në ekskursion ose në ndonjë aktivitet të lirë, këtë gjysmëvjetor ose në gjysmëvjetorin e kaluar?"

Midis tjerash, fëmijët janë pyetur: "A ju ka kërkuar mësuesi (apo ndokush tjetër në shkollë) që të sillni para për të paguar ushqimin në piknik, në ekskursion ose në ndonjë aktivitet të lirë? Figura 13 tregon përqindjen e fëmijëve që janë përgjigjur me "po" në këtë pyetje, të ndarë sipas komunave.

2 Treguesi për pengesat për shkak të kostos del nga tri pyetje (P13, P14 dhe P14b)
Pengesat për shkak të kostos = SHUMA (P 13, P 14, P 14b)

Min=0 dhe Max=3
Kur vlera e treguesit është 1, të anketuarit kanë pasur 1 prej këtyre pengesave. Në diagram është paraqitur përqindja e të anketuarve që kanë pasur së paku një prej pengesave (vlera e treguesit në këtë rast është >=1)

## Dallimet në mes vendeve ku jetojnë fëmijët

**"Është gabim i shkollës për mungesën e pjesëmarrjes në aktivitete shkollore. Shkolla duhet t'i mbulojë më shumë aktivitetet e lira. Nuk duhet t'u kërkohet fëmijëve që të paguajnë!"**

Hulumtimi "*ZëriYnë*" tregon se ka dallime në rrethanat në të cilat rriten fëmijët në Kosovë. Prandaj, kur është fjala për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave dhe nevojave, kjo varet shumë nga ajo se ku jetojnë fëmijët. Figura 14, në vijim, tregon përgjigjet në pyetjen: "A mendoni se fëmijët dhe stafi tjetër i shkollës suaj punojnë në drejtim të ndalimit të talljes (bullying)?" Rezultatet tregojnë një dallim të madh mes komunave të Kosovës. Sipas përgjigjeve të fëmijëve, Gjakova dhe Prizreni gjenden në fund të tabelës, kurse Peja dhe Ferizaji punojnë më shumë në drejtim të ndalimit të talljes (bullying).

## A e ndalon shkolla talljen (bullying)?




Figura 14 Përgjigjet në pyetjen "A mendoni se fëmijët dhe stafi tjetër i shkollës suaj punojnë në drejtim të ndalimit të talljes (bullying)?"

Të rinjtë në komunat e Gjakovës dhe Prizrenit kishin shifra më të larta edhe përsa i përket shqetësimit se familjet e tyre nuk kanë para të mjaftueshme për nevojat e tyre (Gjakova me 15.3% dhe Prizreni me 13.7%). Kjo, me siguri, nënkupton që kjo përqindje e familjeve të fëmijëve të këtyre komunave ballafaqohen me pamundësinë e të siguruarit të mjeteve të nevojshme për përmbushjen e nevojave të fëmijëve të tyre.

Duket se fëmijët që jetojnë në fshatra ndjehen më të sigurt se sa ata që jetojnë në qytete: së paku më të sigurt përsa i përket dhunës. Kur shtrohen pyetjet për përjetimin e dhunës nga të rinjtë e tjerë ose nga të rriturit, shifrat janë dy herë më të larta në zonat urbane se sa në zonat rurale. Po ashtu, fëmijët tallën (bullied) më shumë në zonat urbane (37.7%) se sa në ato rurale (30.9%).




Figura 15 Përgjigjet në pyetjen "A jeni brengosur për një prej çështjeve në vijim gjatë këtij gjysmëvjetori apo gjatë gjysmëvjetorit të kaluar?"

## Dallimet në mes djemve dhe vajzave

**"Ëndërrojmë të kemi një komunikim normal me mësimdhënës, mirëpo ata krijojnë një ndjenjë pasigurie tek ne"**

Hulumtimi "*Zëri Ynë*" ka identifikuar dallime të mëdha mes djemve dhe vajzave përnga mënyra se si e përjetojnë jetën gjatë fëmijërisë. Si djemtë ashtu edhe vajzat shqetësohen se si do t'ia dalin në shkollë, por kjo figurë tregon që kjo përqindje është më e lartë te vajzat se sa te djemtë: 63% për vajzat, 54.3% për djemtë. Këto shifra tregojnë për nivele të larta të stresit dhe presionit, sidomos te vajzat, si dhe për mungesën e mbështetjes në shkollë. Lidhur me sigurinë dhe dhunën, sa më të vjetër aq më të pasigurt ndjehen. Kjo vlen si për djemtë ashtu edhe për vajzat. Mirëpo, derisa vajzat dhe djemtë ndjehen njësoj të sigurt në klasë, jashtë klasës nuk ndjehen njësoj të sigurtë. Djemtë ndjehen më të pasigurtë gjatë pushimeve mes orëve, kurse vajzat ndjehen më të pasigurta në autobus, rrugës për në shtëpi, në orët e mbrëmjes.

Sa i përket çrregullimeve në të ngrënë, kjo figurë tregon se 17.2% e të gjitha vajzave në Kosovë, që domethënë pothuaj 1 në 5 vajza kanë pasur çrregullime të tilla. Po ashtu, 65% e vajzave dhe 61.7% e djemve kanë qenë të pikëlluar dhe në depresion për një periudhë më të gjatë kohore. Këto shifra janë shumë të larta për të dyja gjinitë dhe tregojnë për mungesën e shërbimeve psiko-sociale për të rinjtë në Kosovë. Kjo dëshmon se ekziston një nevojë e madhe për këto shërbime. Shoqëria është e obliguar t'u sigurojë këto të drejta dhe të përmbushë nevojat, në pajtim me Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Si djemtë ashtu edhe vajzat mendojnë se është shumë e rëndësishme që të kenë më shumë ndikim:

87.6% e vajzave dhe 85.1% e djemve. Ky është një mesazh për politikanët e të gjitha niveleve se të rinjve duhet t'u mundësohet pjesëmarrja në vendimmarrje. Kjo ndoshta bëhet edhe më e domosdoshme kur shihen pritjet dhe shpresat e të rinjve për të ardhmen (shih kapitullin "E ardhmja") – një mundësi që të shmangim orientimin nga problemet egzistuese kur punojmë me fëmijët dhe të rinjtë duke dëgjuar zgjidhjet e fëmijëve dhe në të njejtën kohë duke ju besuar aftësive të fëmijëve që të kontribuojnë në zgjidhje.

| DALLIMET NË MES VAJZAVE DHE DJEMVE | | |
|---|---|---|
| | Vajzat | Djemtë |
| Përqindja e fëmijëve që shqetësohen se nuk mund t'ia dalin mirë në shkollë | 63.0% | 54.3% |
| Përqindja e fëmijëve që janë ndjerë rrallë ose që nuk janë ndjerë kurrë të sigurt në transportin publik, në mbrëmje | 8.5% | 6.1% |
| Përqindja e fëmijëve që janë ngacmuar nga fëmijët tjerë, përmes celularëve të tyre | 1.0% | 1.8% |
| Përqindja e fëmijëve që do të donin të kishin më shumë ndikim | 87.6% | 85.1% |
| Përqindja e fëmijëve që kanë pasur probleme dhe çrregullime në të ngrënë | 17.2% | 8.3% |
| Përqindja e fëmijëve që janë shqetësuar për ekonominë e familjes së tyre | 11.8% | 9.7% |
| Përqindja e fëmijëve që janë ndjerë të trishtuar ose të pa disponuar për një periudhë më të gjatë | 65.0% | 61.7% |
| Përqindja e fëmijëve që janë kontaktuar në internet nga një i rritur që dëshironte të bisedonte për seks | 1.9% | 2.8% |
| Përqindja e fëmijëve që shqetësohen për talljen (bullying) & Përqindja e fëmijëve që shqetësohen për ngacmimin | 35.7% | 36.4% |
| Përqindja e fëmijëve që kanë qenë dëshmitarë të dhunës | 8.9% | 10.1% |

Tabela 1 Dallimet në mes djemve dhe vajzave

## Shkolla dhe arsimimi për të gjithë

Mundësitë e barabarta për secilin, pa marrë parasysh gjininë, aftësinë dhe statusin socio-ekonomik, duhet të garantohen nga shteti dhe të sigurohen në shkolla.

Fëmijët që vijojnë arsimin e përgjithshëm vijnë prej vendeve të ndryshme, prandaj shkollat duhet të luajnë një rol kompensues dhe të eleminojnë këtë dallim.

Hulumtimi "*Zëri Ynë*" ka hetuar nivelin e stresit që përjetojnë fëmijët në raport me aktivitetet shkollore.

## Stresi për detyrat e shkollës




**"Secili prind duhet të dijë që fëmija i tij nuk është i shkëlqyeshëm në të gjitha lëndët. Unë, për shembull, e mësoj me vështirësi biologjinë dhe kam shumë stres kur marr notë të keqe, për shkak të familjes."**

Figura 16 Përgjigjet në pyetjen "A jeni ndjerë ndonjëherë të stresuar për detyrat e shkollës gjatë këtij gjysmëvjetori apo gjatë gjysmëvjetorit të kaluar?"

Më se 16.1% e të gjithë të anketuarve kanë thënë se shumë herë stresohen për detyrat e shkollës, 53% kanë deklaruar se ndonjëherë stresohen për detyrat e shkollës, kurse 30.9% kanë deklaruar se nuk stresohen aspak për detyrat e shkollës.

## Stresi për nota




**"Arsyeja pse kemi shumë stres për nota është për shkak të së ardhmes. Jemi të shqetësuar për notat tona, sepse mendojmë se ato e përcaktojnë të ardhmen tonë".**

Figura 17 Përgjigjet në pyetjen : "A jeni ndjerë të stresuar për nota në këtë gjysmëvjetor ose në gjysmëvjetorin e kaluar?"

**"Mësimdhënësit, familja, shoqëria dhe fëmijët në përgjithësi shkaktojnë shumë stres për nota".**

28.3% e fëmijëve që kanë marrë pjesë në hulumtimin "*ZëriYnë*" kanë deklaruar se stresohen shumë herë për nota, 50% kanë thënë se ndonjëherë kanë stres për nota, kurse 21.7% kanë thënë se aspak nuk stresohen për nota.

## Ndihma në shtëpi për kryerjen e detyrave të shtëpisë




Figura 18 Përgjigjet në pyetjen "A ju ndihmojnë në shtëpi lidhur me detyrat e shtëpisë ?"

32.6% e të anketuarve kanë deklaruar se gjithmonë ndihmohen në shtëpi gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë; ndërsa 12.5% kanë deklaruar se asnjëherë nuk ndihmohen në shtëpi për detyrat e shtëpisë. Të dhënat e të njëjtës anketë, të realizuar në Suedi, tregojnë se më se 50% e fëmijëve të intervistuar ndihmohen në shtëpi për të kryer detyrat. Siç shihet, kjo normë është për 18% më e lartë se norma e të anketuarve në Kosovë. Bazuar në këto të dhëna, përfshirja e prindërve në edukimin e fëmijëve, veçanërisht në detyrat e shkollës, është shumë e nevojshme dhe shumë e rëndësishme.

**"Nuk është se prindërit tanë nuk duan të na ndihmojnë. Mirëpo, shumica prej nesh nuk kanë prindër me nivel të lartë arsimi. Prandaj, ata mund të mos dinë si të na ndihmojnë me detyrat e shtëpisë."**

## Mjedisi i punës dhe ndikimi në shkollë

Mjedisi mësimor duhet të jetë i sigurt, stimulues dhe i përshtatshëm për fëmijë. Fëmijët duhet ta shohin shkollën si burim për zhvillimin dhe mësimin e tyre. Shkolla, si e tillë, duhet të mundësojë që fëmijët t'i shprehin lirshëm idetë, sugjerimet dhe shqetësimet e tyre.

**"Dy faktorë janë të rëndësishëm – na jepen shumë detyra të shtëpisë, prandaj nganjëherë na mbeten shumë detyra të shtëpisë pa i kryer në shtëpi. Po ashtu, sistemi i detyrave të shtëpisë nuk është i duhuri – na ndodh të kemi mësuar diçka krejt tjetër në shkollë dhe detyrat e shtëpisë shpesh janë më të vështira se sa ato që i kemi mësuar në shkollë."**

## Ndikimi në shkollë

**"Kërkojmë ndihmë, sepse nuk i kuptojmë mësimet."**




Figura 19. Përgjigjet në pyetjen "A ju ofron shkolla juaj mundësi për të paraqitur mendimet tuaja, për shembull për ushqimet në shkollë, pushimet, detyrat e shkoillës ose gjërat e tjera që kanë të bëjnë me shkollën?"

Figura 19 pasqyron përgjigjet e fëmijëve lidhur me mundësitë për të paraqitur pikëpamjet e tyre lidhur me çështjet e sipërpërmendura. 16.9% e fëmijëve kanë deklaruar se asnjëherë nuk kanë pasur mundësi të japin mendimin e tyre lidhur me çështjet e sipërpërmendura.

**"Nxënësit duhet të kenë zë të barabartë në proceset e vendimmarrjes"**

## Njohuria për të drejtat

**"Scientia est potentia"** – Proverbë latine **"Njohuria është fuqi"**

Secili fëmijë dhe i ri ka të drejta, pa marrë parasysh se kush janë dhe se ku jetojnë. Këto të drejta përfshijnë të drejtën për arsimim, mbrojtje dhe mbijetesë.

Pothuaj secila qeveri në botë ka premtuar të mbrojë, respektojë dhe përmbushë këto të drejta, megjithatë këto të drejta vazhdojnë të shkelen. Prandaj, njohja e këtyre të drejtave është e rëndësishme për të fuqizuar kërkesën për përmbushjen e këtyre të drejtave.

Deklarata e parë botërore për të drejtat e fëmijëve është shkruar nga themeluesja e Save the Children, Eglantyne Jebb, në vitin 1923. Deklarata e Jebb-it për të Drejtat e Fëmijës përbënte bazën e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Më 20 nëntor 1989, Kuvendi i Përgjithshëm i OKB-së miratoi dhe nënshkroi këtë Konventë e cila paraqet të drejtat themelore për të gjithë fëmijët. Kosova ende nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe kjo Konventë mbi të Drejtat e Fëmijës nuk është ratifikuar ende, megjithatë Qeveria e Kosovës përmes Kushtetutës së saj i respekton, mbron dhe përmbush të drejtat e fëmijëve përmes masave të ndryshme, përfshirë këtu masat e përgjithshme për zbatim.

## Vetëdijesimi për të drejtat e fëmijëve




Figura 20. Përgjigjet në pyetjen "A u janë prezantuar të drejtat në shkollën tuaj këtë gjysmëvjetor apo në gjysmëvjetorin e kaluar?" "A keni dëgjuar për të drejtat e fëmijëve?" "A u është prezantuar Konventa për të Drejtat e Fëmijës në shkollën tuaj këtë gjysmëvjetor apo në gjysmëvjetorin e kaluar?" dhe "A keni dëgjuar për Konventën për të Drejtat e Fëmijës?"

Figura 20 paraqet rezultatet e dy pyetjeve lidhur me njohurinë për të drejtat e fëmijës. 96% e fëmijëve janë përgjigjur se kanë dëgjuar për të drejtat e fëmijëve në përgjithësi, me 68.2% të kenë theksuar se kjo temë u është prezantuar atyre në shkollë.

Megjithatë, kur janë pyetur në mënyrë specifike për njohurinë e tyre lidhur me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, 81.3% e të anketuarve janë përgjigjur se kanë njohuri për këtë konventë dhe 53.4% kanë theksuar se kanë mësuar për të në shkollë.

Tabela e mëposhtme i ka ndarë përgjigjet sipas komunës, me 91% të fëmijëve nga Komuna e Mitrovicës të cilët janë përgjigjur pozitivisht lidhur me njohurinë e tyre për këtë Konventë.

Numri i përgjigjeve pozitive në përgjithësi është inkurajues, ku fëmijët janë përgjigjur relativisht pozitivisht lidhur me njohurinë e tyre për Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

## Njohuria për Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës: sipas komunës




Figura 21 Përgjigjet në pyetjen "A keni dëgjuar për Konventën për të Drejtat e Fëmijës?" të ndara sipas komunës

Figura 21 paraqet përgjigjet në pyetjen lidhur me njohurinë për Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës, të ndara sipas komunës.

## Fëmijët që nuk dinë se ku të drejtohen…

Njohja e të drejtave tuaja është e rëndësishme, megjithatë, adresa dhe mënyra e adresimit të tyre atëherë kur këto të drejta shkelen, mbetet ende një sfidë.

50.3% e fëmijëve nuk e dinë se ku të drejtohen kur ballafaqohen me probleme në familje, 41.7% kanë deklaruar se nuk e dinë se ku të drejtohen kur ndjehen të trajtuar padrejtësisht, duke pasuar me 38.9% të të anketuarve të cilët kanë deklaruar se nuk dinë se ku të drejtohen kur janë pjesë e dhunës, kërcënimeve ose krimeve të tjera. Këto janë të dhëna të rëndësishme dhe nuk duhen anashkaluar. Është e domosdoshme që të veprohet dhe të gjurmohet më shumë lidhur me këto tema, në mënyrë që të kuptohen çështjet kryesore që mund t'i shkaktojnë këto rezultate.

## Prania e Avokatit të Popullit në të gjitha komunat

Kur janë pyetur fëmijët "nëse Kosova duhet të bëjë më shumë për të siguruar që çdo komunë të ketë Avokatin e Popullit", 84% e të gjithë fëmijëve kanë deklaruar se është shumë e rëndësishme që Kosova të bëjë më shumë për të siguruar praninë e Institucionit të Avokatit të Popullit në të gjitha komunat.

## E ardhmja

Arsimimi është qenësor për suksesin e fëmijëve tanë dhe familjeve në të ardhmen, prandaj sipas Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, të rriturit duhet t'ua plotësojnë fëmijëve nevojat themelore dhe t'u ndihmojnë atyre që të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Hulumtimi "*Zëri Ynë*" prezanton që fëmijët në Kosovë e mendojnë të ardhmen në mënyrë shumë pozitive, 84% e të gjithë të rinjve në Kosovë e shohin të ardhmen e tyre në mënyrë pozitive.

## Si e mendojnë fëmijët të ardhmen e tyre?




Figura 22. Përgjigjet në pyetjen "Si e mendoni të ardhmen tuaj?"

**"Ju mund të jeni optimist ose pesimist. Kjo varet po ashtu nga mjedisi dhe rrethanat, megjithatë varet kryesisht nga ju."**

